



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 999/2Prot.

Gjirokastrë, më: 21 / 06 / 2024.

V E N D I M
Nr. 16. Dt. 21. 06. 2024

Bazuar në nenin 6, pika 2, gërma a dhe b të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë", si dhe Vendimin Nr. 11 më 07.06.2024, pas marrjes së informacionit dhe shqyrtimit të kërkesës së përcjellë me Vendimin Nr. 5, datë 21.06.2024, ora 08:05 të KZF-së së FSHN-së, lidhur me problematikën e konstatuar në fletët e votimit për autoritetin drejtues "Përgjegjës i Njesisë Bazë" të Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe të Ushqimit, KIZ,

V E N D O S I:

1. Procesi i votimit në Qendrën e votimit Nr. 2 ku voton trupa zgjedhore "Personel Akademik" dhe "Student", të vazhdojë pa u ndërprerë, duke përdorur fletët e votimit të vëna në dispozicion.
2. Në mënyrë që të garantohet ecuria normale e procesit të votimit dhe shprehjes së vullnetit të votuesve të Njesisë Bazë në fjalë, fleta e votimit për autoritetin drejtues "Përgjegjës i Njesisë Bazë" të Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe të Ushqimit të lëxohet si më poshtë:
 - a. Nëse votuesit e kësaj njësie bazë kanë përdorur një nga shenjat e përcaktuara në rregullore brenda kutisë "Voto", kjo votë të lexohet "pro".
 - b. Nëse ka elementë të shprehur për votën "Kundër" atëherë vota të lexohet si e tillë.
 - c. Nëse votuesit e kësaj njësie bazë nuk kanë përdorur një nga shenjat e përcaktuara në rregullore brenda kutisë "Voto", kjo votë të lexohet "votë e pavlefshme".

Vendimi i përcillet KZF-së së FSHN-së në mënyrë të menjëhershme.

K R Y E T A R I

(Emër Mbiemër Firma)

Famirë Boboli

A N Ë T A R

(Emër Mbiemër Firma)

Dhori Terço

A N Ë T A R

(Emër Mbiemër Firma)

Blerta Torre

A N Ë T A R

(Emër Mbiemër Firma)

Drilë Zuli

A N Ë T A R

(Emër Mbiemër Firma)

Ardul Alibej

